

Në kuadër të këtij hulumtimi, janë trajtuar këto çështje:

1. A është zbatuar legjislacioni i cili është aktualisht në fuqi?
2. Identifikimi i mangësive eventuale në legjislacionin aktualisht në fuqi?
3. A janë të definuara qartë kompetencat e MPJ-së dhe institucioneve që bëjnë udhëheqjen e politikës së jashtme të vendit, në ligjet të cilat janë aktualisht në fuqi?
4. A është i nevojshëm miratimi i një Ligji të ri për MPJ-në dhe Shërbimin e Jashtëm?
5. A i adreson këto çështje Projektligji për Shërbimin e Jashtëm, i cili ishte dorëzuar në Kuvend në legjislaturën e kaluar?

Ndërsa disa nga rekomandimet që dalin nga ky hulumtim janë:

Të përcaktohet saktë procedura e rotacionit dhe rastet kur një gjë e tillë i lihet në diskrecion Ministrin/-es së Punëve të Jashtme;

Të përkufizohet kuota e të emëruarve politik në krye të misioneve, dhe në rast se gjykohet e nevojshme (për shkak të mungesës së kadrove në Shërbimin e Jashtëm), të rikthehet kuota e vjetër prej 50%, por që e njëjta të respektohet me përpikmëri;

Të emëruarit në pozitën e Shefave të Misioneve, të cilët nuk vijnë nga radhët e Shërbimit të Jashtëm, pra që janë të emëruar politik, të kenë të përcaktuar kohëzgjatjen e shërbimit të tyre. Të përcaktohet po ashtu nëse atyre iu lejohet zgjatja e mandatit, apo dërgimi në një shtet tjetër, marrë parasysh faktin që pesha politike, në të kaluarën ua ka mundësuar një gjë të tillë. Në legjislacionin aktualisht në fuqi parashihet që të emëruarit politik të shërbejnë vetëm një mandat, mirëpo këtu ka një zbrastë, pasi që nuk precizohet fakti nëse kjo vlen vetëm për shtetin në të cilin janë emëruar, apo të njëjtit mund të emërohen për një mandat tjetër në një shtet tjetër;

Të adresohet çështja e tërheqjes së parakohshme e Shefave të Misionet dhe diplomatëve të tjerë, si dhe të përcaktohen rastet kur një gjë e tillë mund të bëhet, dhe arsytet për të cilat bëhet tërheqja e parakohshme. Ndërrimi i shpeshtë i Shefave të Misionit, sa herë që ndërrohet Qeveria, dëmton imazhin e Republikës së Kosovës në shtetin pritës, dhe tregon jo-qëndrueshmëri institucionale;

Të përcaktohet roli i institucioneve të larta të shtetit (Presidencës, Kuvendit dhe Qeverisë) në politikën e jashtme, pasi që mospajtimet mes tyre lidhur me Shërbimin e Jashtëm, reflektohen edhe në shtetet pritëse, dhe jo-rrallëherë kjo i vë në pozitë të vështirë misionet tona diplomatike dhe konsullore; etj.